

**OBJEKTI : “NDËRTIM GODINA BANIMI NË TERRITORIN E ISH  
REPARTIT USHTARAK NR 8837” SHKOZE PER KOMUNITETIN ROM,  
TIRANE”**

**SPECIFIKIME TEKNIKE TE**

**PERGJITHSHME**



**01/01/2016**

## KERKESA TË PËRGJITHSHME TE PROJEKTIMIT

### PERMBAJTJA

Projekti per adaptimin dhe ndertimin e godinave ne territorin e ish repartit ushtarak ne Shkoze ne sherbim te strehimit te komunitetit rome perbehet nga 14 godina,nga te cilat 4 jane egzistuese. Ne total arrihet nje numer prej 41 apartamentesh ne godinat e reja dhe 20 apartamentesh ne ato egzistuese.

Pra 61 apartamente.

#### PARAMETRAT KRYESORE URBANE TE PROJEKTIT.

SIPËRFAQJA E TRUALLIT QË ZHVILLOHET **11699 M<sup>2</sup>**

SIPËRFAQJA E TRUALLIT E ZËNË NGA STRUKTURA **2428 M<sup>2</sup>**

KOEFICIENTI I SHFRYTËZIMIT TË TRUALLIT **20.8 %**

SIPËRFAQJA TOTALE E NDËRTIMIT MBI TOKË **2428 M<sup>2</sup>**

INTENSITETI I NDËRTIMIT **0.2**

LARTËSIA MAKSIMALE E STRUKTURËS **3.58 M**



## SEKSIONI 1

### TE PERGJITHSHME

#### 1.1 Njësitë matëse

Në përgjithësi njësitë matëse janë njësi metrike në mm, cm, m, m<sup>2</sup>, m<sup>3</sup>, Km, N (Njuton), Mg (1000 kg) dhe gradë celcius. Pikat dhjetore janë të shkruara si "." .

#### 1.2 Organizimi i punimeve

Kontraktori Kryesor do te realizoje ndertimin me burimet e veta ose duke nenkontraktuar pjeserisht apo teresisht punimet ndertimore, konform procedurave, rregullave te nenkontraktimit dhe legjislacionit ne fuqi.

#### 1.3 Kontrolli i Cilesise

Kontraktori Kryesor do te ngreje nje strukture te posacme per kontrollin e cilesise se materialeve dhe punimeve, duke nenkontraktuar laborator te licensuar ne kete fushe. Plani i kontrollit te cilesise se punimeve do te jete i detyrueshem edhe per nenkontraktoret.

## SEKSIONI 2

### INFRASTRUKTURA

#### 2.1 Rruget

Rruga kryesore e kompleksit do te jete e projektuar sipas kushteve teknike te projektimit te vitit 2001, me gjeresi 5 m , me dy kalime. Rruget do te kene ne te gjithe gjatesine nyje te trajtuara per qarkullim normal te mjeteve te perdorimit individual, dhe ato komunale apo te mbrojtes nga zjarri.Ne te dyja anet trotuare me gjeresi 1.5 m. Rruga do te jete me dy pjerresi, me kuneta per mbledhjen e ujrave te shiut nga te anet.

#### Materialet

Shtresat rugore jane trajtuar dhe projektuar me poshte:

Shtrese zhavori lumi t=30cm, perhapur e ngjeshur me makineri

Shtrese stabilizant t=10cm

Sperkatje me emulsion bituminoz 0.5 l/m<sup>2</sup>

Shtrese binderi me zall lavatrice,4cm,me makineri

Shtrese asfaltobetoni me zall lavatrice, 3cm, me makineri

Te gjitha meterialet do te jene konform stadarteve te ndertimit:

STASH 660-87

STASH CNR Nr. 1996

STASH 651-87,

BS 812

## **2.2 Trotuaret**

Trotuaret e rrugeve do te jene ne te dy anet e rruges me gjeresi 1.5 m. Trotuari do te ndertohet mbi nenshtresa te trajtuara me rrulim, dhe betoni C 16/20, Trotuaret do te ndertohen pasi te jene perfunduar bordurat kufizuese te betonit.


### **MATERIALET**

Shtrese zhavori lumi t=30cm, perhapur e ngjeshur me makineri

Trotuar me lluster cemento, pa borduren e betonit

Shtrese betoni C 16/20 nen bordure

Bordura betoni 15x25 cm



Trotuari do te kete pllaka betoni, te cilat do te shtrohen me rere te lare.

## **2.3 Ndriçimi rrugor**

Rruget jane parashikuar me ndricim rrugor cdo 30 m, me keto karakteristika:

shtylla elektrike 5m me nje llampe 150w.

## **2.4 Gjelberimi rrugor**

Ne cdo trotuar do te mbillen fidane shkurre dekorative "Oleander", dhe peme dekorative kumbull e kuqe.

## **2.5 Rrjeti i kanalizimeve te ujrave te bardha**

Rrjeti i kanalizimeve te ujrave te bardha eshte projektuar me me diameter nga 110 mm deri ne 200 mm, me puseta shkarkimi cdo 25 m . Pusetat jane parashikuar me thellesi nga 1 m deri ne 1.5 m.

Materialet dhe punimet

- Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m<sup>3</sup>, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet.
- Tub kanalizimi pvc Ø 200 mm.
- Pusete b/a shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize.
- Shtrese rere.

## 2.6 Rrjeti i kanalizimeve te ujrave te zeza

Rrejtji i kanalizimeve te ujrave te zeza eshte projektuar i ndare nga ai i ujrave te bardha. Rrjeti eshte konceptuar i perbere nga linjat e banesave tip te cilat shkarkojne ne rrjetin sekondar, dhe me tej ne ate kryesor.

Kolektoret kryesor bashkohen dhe shkarkojne ne impiantin e frajtimit te ujrave te zeza, i cili ndodhet ne distance nga kompleksi.

Materialet dhe punimet

- Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m<sup>3</sup>, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet.
- Pusete shkarkimi b/a, 50 x 50 cm, h = 100 cm.
- Pusete shkarkimi b/a, 80 x 80 cm, h = 150 cm.
- Tub kanalizimi pvc Ø 140 mm.
- Tub kanalizimi pvc Ø 200 mm.
- F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=400 mm.
- Shtrese rere.

## **Materialet te pergjithshme**

Shkarkimet e banesave do te behen me tub PVC me diameter 200 mm

Pusetat e kanalizimeve te ujrave te zeza do te jene te parapregatitura ose beton te derdhur ne vend

Kapaket e pusetave ne rruge do te jene prej betonarmeje ose prej gize, sipas projektit. Kapaket dhe kornizat do te parashikohen sipas hapesires drite te pusetes, siç eshte treguar ne vizatime.

Punimet civile, transporti, magazinimi, ndertimi, testimi i rrejteve te kanalizimeve do te behet konfor standarteve kombetare e nderkometare te fushes.

## **2.7 Rrjeti i furnizimit me uje te pijshem**

Rrjeti i furnizimit me uje te pijshem eshte projektuar sipas normave shqiptare te projektimit dhe normave te huaja te perparuara ne kete fushe

Norma ditore e konsumit te ujit eshte parashikuar 240 litra/dite per person e cila perfshin te gjitha nevojat shtepiake te banorit, si pirje, gatim, larje trupi, larje teshash, tualete, pastrim banese, ujitje vazo lulesh, dhe per ambjente te perbashketa.

Furnizimi me uje do te kryhet nga rrjeti kryesor .

Materialet dhe pajisjet hidrosanitare.

I-Furnizimi me uje+KUZ(brenda)

-bolier 100 l importi

- lavaman porcelani importi

- WC allaturka importi

- tub kanalizimi PVC 110

-tub kanalizimi PVC 50

- tub te zeze dhe rakorderi
- saracineska bronzi Ø 1/2 " = 15 mm

## **2.8 Rrjeti i mbrojtjes nga zjarri**

Sipas KTP ( Kushteve Teknike te Projektimit) ne fuqi,per qendra te banuara deri ne 25000 banore,rryma e ujit zjarrfikes eshte 5 l/sek dhe kohezgjatja e shuarjes se zjarrit pranohet 3 ore.

Harxhimi i ujit per nje hidrant te jashtem, merret 5 l/sek.

Hidrantet e jashtem kunder zjarrit vendosen gjate rrugeve, ne largesi jo me shume se 70 – 100 m nga njeri-tjetri dhe jo me afer se 5 m nga muret e jashtme te ndertesave.

Rrjeti i hidranteve ne objekt eshte parashikuar i tipit unazor, me tub PE 100/10 bar, D140 mm,me trashesi te murit 8.3 mm.

Tubacionet e rrjetit zjarrfikes instalohen ne te njejten transe me tubacionin e ujit te pijshem. Sipas projektit te zbatimit



## **SEKSIONI 3**

### **PUNIME DHERASH**

#### **3.1 Germimi**

Gërmimi duhet te kryhet në përputhje me nivelet dhe vijën e prerjeve siç tregohet ne Vizatime. Çdo thellësi me e madhe e gërmuar nen nivelin e formacionit, brenda tolerancës se lejuar, duhet te behet mire me mbushje me materiale te pranueshme dhe me karakteristika te ngjashme nga Kontraktori me shpenzimet e tij.

Kujdes i veçantë duhet te ushtrohet kur gërmohen prerje për te mos hequr material përtej vijës se specifikuar te prerjes dhe me pas duke shkaktuar rrezikshmëri për qëndrueshmërinë strukturore te pjerrësisë ose duke shkaktuar erozion ose disintegrimin e pjesëve te ngjeshura.

#### **3.2 Trajtimi/ Ngjeshja e zonave te germuara**

Te gjitha zonat horizontale te germuara duhet te ngjeshen me një minimum dendësie te thatë prej 95% për dhera te shkruket dhe 90% për dhera te lidhur.

### 3.3 Germimi per strukturat

Gërmimi për strukturat duhet të jete në përputhje me Vizatimet. Anët duhen mbështetur në mënyre të përshtatshme gjate të gjithë kohës. Një alternativë është që ato mund të ngjeshen në mënyre të përshtatshme.

Gërmimet duhet të mbahen të pastra nga uji. Tabani i të gjithë gërmimeve duhet të nivelohet me kujdes. Çdo pjese me material të bute ose mbeturina shkëmbi në taban duhet të hiqet dhe kaviteti që rezulton të mbushet me beton.

## SEKSIONI 4

### PUNIME BETON ARME

#### 4.1 Betoni

Betoni i përdorur do të jete i markave të ndryshme sipas projektit. Betoni do të prodhet në nyjet e betonit dhe do të transportohet në kantiere me autobetoniere. Betoni do të hidhet në veper me beton pompe ose me autobetoniere .

**Çimento** e betonit do të jete e zakonshme e tipit Portland, ose me ngurtësim të shpejtë.

**Inertet**, e imeta dhe të trasha për prodhimin e betonit do të jete të pastra me granulometri dhe kërkesa teknike në përputhje me standartet e prodhimit të betoneve. Agregatet e ashpër duhet të jete kimikisht inerte, të forta, me porozitet të kufizuar dhe të mos përmbajnë argjile, qymyr dhe papastërti organike apo të tjera që mund të shkaktojnë korrozion të armaturës ose rënie të fortësisë dhe durueshmërisë së betonit.

**Uji**, duhet të jete i pastër dhe të mos përmbajë rëre, zhavorr, përqendrime acidesh, alkalesh, kripëra, sheqer dhe substanca të tjera kimike organike. Uji i përdorur do të jete i pranueshëm për përdorim me beton dhe llaç.

**Aditivët**: Aditivët përdoren në raste specifike, si në rastet e temperaturave të ulta ose shumë të nxehta, kur kërkohet ngurtësim i shpejtë i betonit, kur kërkohet beton dekorativ etj. Në të gjitha rastet e mësipërme aditivët do të aprovohen nga inxhinieri i kontraktorit kryesor.

## SEKSIONI 5

### PUNIME MURATURE

#### 5.1 Muratura



Muret e strukturave(banesave do te jene)Mur me blloqe betoni 20cm deri - 3m me ll p M 15 per muret perimetrale dhe Mur me blloqe betoni t=15cm deri 3m me llaç perzier M 15 per muret e brendshme.Muret e brendshme do te jene te suvatuara dhe te lyera me boje hidromat.

Punimet e muratures, materialet qe do te perdoren, kontrolli dhe marrja ne dorezim e tyre do te behet ne perputhje me kushtet teknike ne fuqi.

## **SEKSIONI 6**

### **6.2 Shtresa/veshje me pllaka/memer**

#### **6.2.1 TE PERGJITHSHME**

Sshtrimet/ Veshjet me pllaka dhe mermere jane parashikuar ne projektin arkitektonik per tu aplikuar ne ambientet e brendshme te banesave.

#### **6.2.2 MATERIALET**

Materialet qe do te perdoren per sstrime dhe veshje do te jene si me poshte:

- Veshje me pllaka majolike
- Sshtrim me pllaka porcelanat importi
- Plintuse pllake grez
- Pragje dritaresh me mermer T=2CM
- Pragje dyesesh me mermer T=3CM
- Pragje dyesesh me mermer T=2CM
- Kollle
- Bojak
- Silikon
- Llac cemento
- 

#### **6.2.2.1 PUNIMET E HIDROIZOLIMIT DHE CATIA**

- Hidroizolimi do te kryhet perpara se te vendosen shtresat finale te pllakave/mermereve etj. Hidroizolimi do te kryhet edhe per catine.Catia do te jete konstruksion metalik me panele sanduic.

Materialet per hidroizolim.

Shtrese lluster çimento 1:2

Hidroizolim me emulsion dhe 2 duar bitum

Shtrese lluster çimento 1:2 ne cati

Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 shtrese katrama

### 6.2.3 APLIKIMI

Shtrimi/veshja do te kryhet konform vizatimeve dhe instruksioneve te prodhuesit dhe standarteve te fushes.

- Ambjentet e brendshme te banesave do te shtrohen me pllake.
- Veshjet e banjove do te shkojne deri ne lartesine 2.40 m nga dysHEMEJA .
- Pas perfundimit te shtimit te pllakave drejtuesi i objektit ushtron kontrollin per respektimin e kuotes, rrafshesise, pamjes estetike, vizave te drejta te fugave, ngjeshmerise se mire, tingullit te mire dhe te qarte pas goditjes me çekiç gome, pastrimit te fugave, gjithmone duke shikuar nga pozicioni i kundert i renies se drites dhe me pas nenkontraktori pastron fugat, siperfaqet e pllakave nga pluhurat dhe papastertite, aplikon bojakun . Mbase te jete ngurtesuar bojaku behet pastrimi i siperfaqes, ku ferkimi behet gjithmone ne drejtimin diagonal te pllakave. Fugat e pllakave mund te jene nga 2 mm deri ne 4 mm ne varesi te dimensionit te pllakave dhe kerkesave te projektit.
- Ne ambientet te cilat do te kerkojne plintusa, ato do te priten nga pllakat eksistuese nga nenkontraktori dhe do te montohen me kolle..
- Per veshjet e banjove ne fuga e kendeve si horizontale ashtu edhe ato vertikale do te vendosen kendore plastike .
- Pllakat duhen te jene te mbushura ne 100 % te siperfaqes me kolle dhe te jene te niveluar me tolerance brenda  $\pm 1$  mm per 3 m mastar.
- Shtrimi i mermerave do te realizohet me llac cemento 1:2
- Specialistet do te punojne me kepuce gome, dhe do bej kujdes per ruajtjen e hidroizolimit.
- Mermeret do te vendosen ne nivel dhe sipas porosise se inxhinierit te objektit .
- Plintuset e mermerit do te vendosen me kolle.

### 6.2.4 INSPEKTIMI DHE MARRJA NE DOREZIM E PUNIMEVE

Inspektimi do behet gjate procesit te aplikimit pas saj, me qellim kontrollin e elementeve te meposhtem:

- kuotat
- materialet
- puthitjen
- fugat
- tolerancat
- vertikaliteti
- horizontaliteti
- hapjet drejtkendore ose rrethore

Marrja ne dorezim e punimeve do behet me nje procesverbal dypalesh ku do shenohen te gjithë elemetet e mesiperm.

## 6.4 Suvatimet e brendshme

Suvatimet e brendshme do te behen me llac tradicional gelqereje te markes M-25.

Suvatimet do te behen me tre faza: Spruco me rere dhe cemento, fasho dhe mbushje, fino perfundimtare.

Suvatimet janedy llojesh ne murature me blloqe betoni per objektet e reja dhe ne murature tulle 25 cm ne mure egzsituese.( Suva e zakonshme fasade mur tulle h ~ 8 m)

## 6.5 Pragjet

Pragjet e dyerve/dritareve do te jene me mermer te thjeshte. Pragjet do te vendosen pasi te jete vendosur dritarja ne davancalin e jashtem. Pragjet do te dalin 1 cm jashte muratures se perfunduar, gjithashtu do te futen edhe ne dy drejtimet ansore nga 1cm. Pragu do te jete i smusuar ne pjesen e sipërme te dritaret.

## 6.10 Dritaret

Dritaret do te jene d/alumini tek xham.

## 6.11 Dyert e brendshme

Dyert e brendshme do te jene dyer d/alumini tek xham dhe dyer druri.Dimensionet e dyerve do te jene: 80,90, cm gjeresia dhe 215cm lartesia. Keto dimensione jane te perfunduara.

## 6.12 Dera kryesore

Dera e jashtme do te jete material druri me permasa 90x220.

## 6.15 Lyerje me boje jashte

Nuk ka .Lihet ne dukje materiali i bllokut te betonit.

## SEKSIONI 10

### INSTALIMET ELEKTRIKE

#### 10.1 Furnizimi me energji elektrike nga rrjeti

Ndërtimi i objekteve duhet të përfshijë edhe instalimin e ri elektrik.

Eshte parashikuar ndriçimi i dhomave me ndriçues me fuqi të mjaftueshme për të garantuar një ndriçim në përputhje me normat në fuqi, dhe një numër të mjaftueshëm prizash për secilin ambient, sipas destinacionit të tyre.

Eshte parashikuar instalimi i rrjetit elektrik trefazor me fuqi të tillë që të sigurojë funksionim normal të sistemit të ngrohjes. Panelet e komandimit jane vendosur të rinj sipas standarteve bashkëkohore.

Eshte parashikuar vendosja e matësit elektrik trefazor, lidhjen e kontratës me Zonën e Shpërndarjes Elektrike Tiranë, si dhe vlerën e përafërt të shtrimit të kabllit nga sahati deri te pika e lidhjes së miratuar si dhe vlera e tarifave të CEZ-it.

Materialet dhe elementet.

Panel I matjes se energjise 1/3 fazor, 10 poste

Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16°

Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 10°

Kuti suport pllaket 3 mod

Kuti derivacjoni PT-4plastike

Kuti derivacjoni PT-6 plastike

priza shuko "Gevis" universal

Çeles 1 polar 220V 10A "Vimar"

Tubo PCV fleksibel Ø 22-26

Tub plastmasi Ø 18-21mm

Montim kanalinash Ø 20+kapse

Portollampa norm 10 A


Llampa te thjeshte

Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=2.0m

Percjelles CU PV-500; 1.5mm<sup>2</sup>

Percjelles CU PV-500; 2.5mm<sup>2</sup>

Shtize rrufepritese l=1.5m



Gjithsesi per me teper duhet te shikoni projektin e zbatimit .

### 10.3 Mbrojtja nga shkarkimet atmosferike

Mbrojtja nga shkarkimet atmosferike do te realizohet me ane te nje sistemi rrufe prites ne forme rrjete te shtrire neper tarace . Sistemi do te realizohet me hekur te zinkuar Ø10 i cili kapet ne cati me ane te morsetave te posaçme.

Pritesit do zbresin ne toke me ane te disa zbratesave hekuri te zinkuar Ø10 te instaluar ne kollonat perkatese te godines qe gjate ndertimit te tyre. Gjatesia e zbratesave duhet te llogariten qe te jene te pa keputur gjate gjithë gjatesise qe nga lidhja me pritesin deri ne puseten e bashkimit me percjellesin e tokezimit te tokezuesit te vendosur reth 1ml ne nivelin 00 te baneses. Specifikimet per realizimin e zbratesave jane pershkruar ne vizatimin perkates. Bashkimi i pritesave me zbratesat do realizohet me saldim me siperfaqe saldimi mbi 100mm<sup>2</sup>. Lidhja e tyre me zbratesat do realizohet te pakten ne dy vende. Secila zbritje e sistemit mbrojtjes nga shkarkimet do te lidhet me nje apo me shume elektroda tokezimi 1.5m per te arritur nje rezistence tokezimi deri 10 Ohm.


Te gjitha elementet metalik qe ndodhen ne tarace do te lidhen me sistemin e mbrojtjes nga

shkarkimet atmosferike.

Gjithsesi per me teper duhet te shikoni projektin e zbatimit

## 10.6 Ambientet e banesave

Lartesite e Vendosjes se prizave dhe çelsave ne ambiente te ndryshme eshte treguar ne vizatimin e meposhtem:



### Ambienti i dites

Mendojme qe ky ambient ka nevojte per ndricim te niveleve te ndryshme, ne varesi te aktivitetit qe behet (te pergjithshem, per lexim, shikim televizori).

Persa i perket prizave eshte parashikuar vendosje prizash per TV,TP (telefon) dhe ndonje prize qe perdoret per furnizimin e aparaturave te pastrimit, dhe e ndricimit suplementar nga toka (abazhur dekorativ ne kembe).

### Kuzhina

Kuzhina eshte nje ambient qe nuk konsiderohet nga normat si i veçante (kur nuk jane te nevojshme lidhjet ekuipotenciale suplementare). Kur eshte e mundur eshte mire te rakordohet puna me pare per pozicionin. Vendosja e prizave ne projekt i eshte pershtatur vendosjes se paisjeve elektro shtepiake. Cdo ndryshim i vendosjes se paisjeve duhet te shoqerohet edhe me ndryshimin e vendosjes se prizave.

Ne kuzhine eshte parashikuar dalje fuqie tre fazore per soben e gatimit,dalje prize per frigorifer.

### **Tualeti**

Problemi i sigurise eshte shume i rendesishem per keto lloj ambientesh.

Per kete qellim paisjet elektrike jane larguar nga zonat e rrezikshme sipas normave te caktuara.

Ne pergjithesi eshte vendosur nje ndriçues ne tavan .

Vendosja e zgjedhja e prizave me lartesite perkatese standarte eshte bere ne baze te fuqise paisjes qe do te furnizojë dhe te mobilimit. Keshillojme qe gjate punes per instalimet elektrike ne keto ambiente te diskutohet me instalatoret hidraulike sepse per arsye te ndryshme mund te kete ndryshime te pozicionit te vendosjes se paisjeve te tualetit. Si rrjedhoje do te ndryshojë dhe instalimi elektrik.

### **Dhomat e gjumit**

Eshte menduar qe ndriçimi kryesor ne keto ambiente te komandohet ne hyrje. Ne keto ambiente eshte parashikuar prize per abazhur, dhe prize per radio. Per kete ambient eshte menduar e pershtatshme gjithashtu vendosja e prizes se televizorit.

Gjithsesi per me teper duhet te shikoni projektin e zbatimit

### **Ndricimi i Jashtem/ Ndricimi i Sigurise**

Sistemi i ndriçimit te jashtem eshte projektuar qe te kryejë si ndricimin dekorativ ate funksional por edhe per te sherbyer si ndricim kontrolli e sigurie.

Projekti i paraqitur permban vetem pikat e ndricimit dhe rrugen ku mund te kalohet per instalimin e tyre. Ne bashkepunim me arkitektin do te percaktohen tipet e ndriçuesave si dhe mund te behen spostime perkatese.

## **SEKSIONI 12**

### **SISTEMIMET E JASHTME**

#### **12.1 Punimet civile**

Punimet civile per sistemimet e jashtme perfshijne germimet, shtresat, punimet e betonit pe trotuare dhe muret e banesave.

Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 20/25 do te ngrihen per te sistemuar parcelat sipas kuotave te projektit dhe per te mbrojtur nga rreshkitjet e dheut. Parcelat qendrore per parkun e kompleksit do te jete e sistemuar sipas kuotave te dhena nga arkitekti, dhe e gjelberuar.